



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1676/ 10 prot.

Datë 09/09/2025

V E N D I M
Nr. 1205/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/09/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1109/2025, datë 25.08.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eidon Grup” SHPK & “Junik” SHPK & “Nigma Konstruktion” SHPK me NIPT L91323019S, J68007522L dhe L31626006F me adresë: Rruga “Kodra e Diellit”, Ndërtesa Nr.2, Hyrja 15, Ap.11, Farkë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për Miratimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.08.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1109/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1325/10 prot., datë 02.09.2025, me objekt “Dërgim informacioni për zbatimin e Vendimit nr. 1109/2025, datë 25.08.2025 të KPP-së lidhur me në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-45954-04-24-2025 me objekt Instalim Panele Diellore”, protokolluar me tonën nr. 1676/7 prot., datë 04.09.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., ka dërguar zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1109/2025, datë 25.08.2025, duke e rivlerësuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Junik” SHPK & “Edion Grup” SHPK & “Nigma Konstruksjon” SHPK në procedurën e

prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë*” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “*Instalim Panele Diellore*” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1325/10 prot., datë 02.09.2025, me objekt “*Dërgim informacioni për zbatimin e Vendimit nr. 1109/2025, datë 25.08.2025 të KPP-së lidhur me në procedurën e prokurimit me Nr.Ref-45954-04-24-2025 me objekt Instalim Panele Diellore*”, protokolluar me tonën nr. 1676/7 prot., datë 04.09.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., ka dërguar zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1109/2025, datë 25.08.2025, duke e rivlerësuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Junik*” SHPK & “*Edion Grup*” SHPK & “*Nigma Konstruksjon*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë*” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “*Instalim Panele Diellore*” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1109/2025 datë 25.08.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Junik*” SHPK & “*Edion Grup*” SHPK & “*Nigma Konstruksjon*” SHPK. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1109/2025, datë 25.08.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetarë” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me objekt “Instalim Panele Diellore” me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

